



Empowered lives.
Resilient nations.

Improving Coverage and Effectiveness Management of Marine and Coastal Protected Areas

Permiresimi i Efektivitetit të Mbulimit dhe Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Detare dhe Bregdetare

VIZITE STUDIMORE NE PARKUN KOMBETAR PRESPE ME STAFIN E ADMINISTRATES SE ZONAVE TE MBROJTURA VLORE



Përshkrimi i aktivitetit

Ne kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të administratës të PKD Karaburun-Sazan zyra e projektit ka zhvilluar një vizite studimore në PK Prespës me stafin e AdZM Vlore i cili menaxhon dhe monitoron ZMD Karaburun-Sazan. Qëllimi i vizitës është njohja me praktika me të zhvilluara të menaxhimit dhe monitorimit të një Zone të Mbrojtur. Gjatë vizitës stafi i AdZM, në mënyrë specifike personeli i dedikuar menaxhimit dhe monitorimit të Parkut Detar Karaburun-Sazan do të njihet me aspektet menaxheriale të PK Prespe, procesin e monitorimit dhe qasjen e administratës së parkut në bashkëpunimin institucional me organet vendore dhe komunitetin vendas. Kjo vizite është në vijimësi

te aktiviteve te ngjashme qe projekti ka zhvilluar per rritjen e kapaciteteve menaxhuese dhe monitoruese te stafit i cili merret me menaxhimin e Parkut Kombëtar Detar Karaburun-Sazan. Njëkohësisht kjo vizite do te shërbej për vendosjen e urave bashkëpunuese dhe praktikave te mira menaxhuese duke shkëmbyer eksperiencën dhe rritur aftësitë e administratave te ZM ne nivel zonal e kombëtar.

Informacion mbi zhvillimin e aktivitetit

Referuar programit, i cila u përgatit ne bashkëpunim me stafin e administratës se PK Prespe, u zhvilluan këto aktivitete ne PK Prespe:

a) Vizite ne qendrën e informacionit te PK Prespe

Gjate kësaj vizite ne qendrën e re te informacionit te PK Prespe nga ana e stafit te parkut u njohëm me qendrën, funksionin dhe kufirin hyrës te parkut. Përgjegjësi i monitorimit ne PK Prespe Z. Olsi Duma, gjate vizitës informoi mbi procesin e monitorimit dhe informimit te administratës se parkut. Ne këtë takim u bisedua mbi funksionin e kësaj qendre dhe rolin qe kryen. Stafi i AdZM Vlore u interesua për aspektet monitoruese te parkut nga ana e vrojtuesve dhe rolit te tyre.

- Funksioni i vrojtuesve;
- Raportimi dhe procesverbal konstatimi;
- Masat për aktivitetet e jashtëligjshme;
- Qasja dhe komunikimi me komunitetin.

b) Vizite ne qendrën e zyrave te parkut Prespe

Ne takimin e zhvilluar ne zyrën e parkut, drejtori i AdZM Korçë Z. Mihallaq Qirjo, njohu koleget nga Vlora mbi progresin dhe punën ne këtë park. Z. Qirjo u nda ne dy aspekte thelbësore qe duhet te jene, sipas mendimit te tij, linja guide ne punen e perditshme:

- ***Bashkëpunimi me komunitetin:*** Ne punën e përditshme përqasja ne komunikimin me komunitetin është thelbësore. Politika e ndjekur duhet te jete ajo e një bashkëpunimi dhe koordinimi për sa i takon aktiviteve dhe veprimtarive te ndryshme. Përfshirja e tyre ne konsultime dhe diskutime si dhe roli ne vendimmarrje janë kapilare te nje suksesi te garantuar.
- ***Plani i Menaxhimit:*** Për një administrate te ZM është ligj zbatimi i Planit te Menaxhimit, është dokumenti me i rëndësishëm ne te cilën duhet te bazohet administrata.

Ndërkohe qe përgjegjësi i Menaxhimit Z. Vasil Male, beri një prezantim te shkurtër mbi rëndësinë e parkut, hapat e ndërmarra, aktivitetet dhe ndërhyrjet e rëndësishme dhe prioritare qe behën ne park. Ai vuri theksin ne rëndësinë qe ka menaxhimi sa me i mire dhe bashkëpunimi me aktoret dhe projektet e ndryshme me qellim përfitimin e sa me shume te mirave materiale dhe kapaciteteve te ndryshme si logjistike ashtu dhe profesionale.

c) Vizite ne zonën buferike te parkut Prespe

Me pas u zhvillua edhe një vizite ne terren për te pare ndërhyrjet e ndryshme te bëra ne zone nga stafi i parkut Prespe, kryesisht ne zonën buferike ku problematika ka te beje me aktivitetin e paligjshëm te prerjes se drurëve dhe ku ne bashkëpunim me institucionet dhe donatoret, ne mirëkuptimin edhe me komunitetin, është ndërhyrë për përmirësimin e kushteve dhe zonave me problematike.

Vlerësimi i vizitës nga pjesëmarrësit

Pas përfundimit te vizitës ne PK Prespës stafi i administratës se AdZM Vlore plotësoi një pyetësor te përgatitur nga zyra e projektit.

Pyetësori kërkon te marr një vlerësim nga ana e stafit për sa i takon vizitës studimore duke marr mendimet dhe opinionet e tyre për përfitimet dhe sugjerimet lidhur me këtë vizite. Si vijon një përmbledhje e rezultateve:

a) Vlerësimi i vizitës

Nga ana e stafit te AdZM Vlore, vizita vlerësohet shume pozitivisht pasi ndihmon ne rritjen e njohurive dhe praktikave me te konsoliduar. Vlerësohet organizimi dhe bashkëpunimi me administratën e parkut Prespe. Vlerësohet mikpritja dhe disponibiliteti i treguar nga zyra e projektit dhe administrata e parkut Prespe.

b) Pritshmëritë

Për sa u takon pritshmërive te vizitës, stafi i AdZM Vlore mendon se vizita ne përgjithësi i përmbushi pritshmërite por ka akoma nevojë për tu njohur me praktika me te konsoliduara dhe te ngjashme me zonën. Ne parkun kombëtarë Prespe nder aspektet qe vlerësojnë me shume është qasja e administratës me komunitetin lokal dhe organizimi i administratës ne menaxhim, monitorim dhe ndërhyrje konkrete ne zonën e parkut.

c) Njohuri te reja

Ne vizitën e parkut stafi i administratës vlerëson njohjen me mënyrën e organizimit te monitorimit ne park dhe rëndësisë qe vrojtuesit i jepnin përfshirjes se komunitetit si një aleat i tyre ne punën e përditshme. Një tjetër aspekt me rëndësi ishte organizimi i punës ne monitorim dhe menaxhimi i parkut nëpërmjet organizimit te aktiviteve me komunitetin. Nga ana e stafit vlerësohet mjaft pozitivisht edhe botimi i planit te menaxhimit te parkut, praktike e cila duhet te konsiderohet për PKD Karaburun-Sazan, dhe dokumenteve te tjerë te cilat lehtësojnë dhe ndihmojnë administratën në punën e tyre te përditshme.

Tjetër aspekt i cili vlerësohet është ndërhyrja qe behet ne park duke pasur parasysh nevojat qe ka zona dhe qe e lidhin me parkun.

d) Nevoja per praktika te tjera menaxhuese

Stafi i AdZM Vlore pjesëmarrës vlerëson si mjaft pozitive dhe te nevojshme shkëmbimin e vizitave te tilla studimore për te rritur njohuritë e tyre dhe për tu njohur me praktikat me te mira menaxhuese dhe monitoruese ne vend.

Per kete arsye ata shohin si te nevojshme dhe propozojnë aktivitete te tjera si vijon:

- Vizite studimore ne ZM Butrint;
- Vizite studimore ne Liqenin e Shkodrës;
- Vizita studimore jashtë vendi ne ZM ndërkufitare;
- Aktivitete te cilat rrisin kapacitetet vrojtuese dhe menaxhuese.

Stafi i AdZM shprehu gatishmërinë qe te mirepres stafin e PK Prespe ne nje vizite studimore ne PKD Karaburun-Sazan.

AXHENDA

Dita 1- 24 Nëntor 2015

15.00	Nisja nga Vlora/ Orikum
19.30	Mbërritja ne Korçë
19.30 - 20.00	Akomodimi ne hotel
20.00	Darka

Dita 2- 25 Nëntor 2015

09.00	Nisja për ne Parkun e Prespës
10.00 - 12.00	Takimi prezantues me administratës e parkut Prespe <ul style="list-style-type: none">- Prezantimi i çështjeve kryesore te menaxhimit ne PK Prespe- Detyrat e vrojtuesve dhe shkëmbim eksperience- Diskutim mbi çështje te ndryshme
12.00 – 12.30	Vizite ne qendrën e informacionit
12.30 – 13.30	Vizite ne parkun e Prespës
13.30 – 15.00	Dreka
15.00	Nisja për ne Vlore/ Orikum

PJESEMARRES:

1.	Nexhip Hysolakoj	AdZM
2.	Florian Rustemi	AdZM
3.	Gani Vangjeli	AdZM
4.	Saimir Brahim i	AdZM
5.	Ilva Alushaj	AdZM
6.	Artan Jazo	vrojtues
7.	Xhelo Lazemetaj	vrojtues
8.	Florant Begotaraj	vrojtues
9.	Jani Kushta	vrojtues

Foto nga Aktiviteti



Permiresimi i Efektivitetit te Mbulimit dhe Menaxhimit te Zonave te Mbrojtura Detare dhe Bregdetare



Permiresimi i Efektivitetit te Mbulimit dhe Menaxhimit te Zonave te Mbrojtura Detare dhe Bregdetare

